

VENDIM
Nr. 33, datë 25.5.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

me sekretare admira babaj, në datën 14.04.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 4 akti që i përket:

KËRKUES: Hamza Hamzai (përfaqësues i trashëgimtarëve ligjorë të Qefser Hamzait)

SUBJEKTE TË INTERSUARA: Fitim Hamzai, Ilirjan Hamzai, Florjan Nuri, Tatjana Nuri, Migena Nuri (trashëgimtarët e Astrit Nurit)

Shoqëria “Labi” sh.p.k., Vlorë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 1302, datë 01.06.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi). Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që kërkoj pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari, i cili është një nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Qefser Hamzai, në vitin 1993 ka vërtetuar faktin juridik të pronësisë së babait të tij mbi sipërfaqen 8952 m² me vendimin gjyqësor nr. 1733, datë 13.10.1993, duke e regjistruar edhe në Zyrën e Hipotekës në Vlorë në vitin 1994.

2. Kërkuari më pas i është drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP-ja) Vlorë me kërkesë për njohjen pronar të babait të tij mbi sipërfaqen 8952 m², kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. 61, datë 29.11.1994 të KKKP-së, që ka vendosur kthimin në natyrë të 8102 m², pasi 850 m² rreth banesës ishin në posedim të tij.

3. Në vitin 2003 kërkuari, me pretendimin se vendimi i KKKP-së ishte i paplotë, sepse i mungonte skica, e ka kundërshtuar atë në rrugë gjyqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka caktuar ekspert për të përpiluar planvendodhjen e pronës së kthyer në natyrë, ka vendosur pranimin e padisë dhe plotësimin e vendimit të KKKP-së.

4. Në vitin 2007 subjektet e interesuara kanë vënë në lëvizje paralelisht dy procese: një proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe një proces administrativ përmes denoncimit të paraqitur nga Astrit Nuri, pranë Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit pranë Këshillit të Ministrave, me pretendimin e paligjshmërisë së procedurave të ndjekura për kthimin

dhe regjistrimin e pronës nga KKKP-ja Vlorë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesëpadinë e subjekteve të interesuara me objekt *“Pavërtetësi e faktit juridik të vërtetimit të pronësisë së trashëgimtarëve Qefser Hamzai dhe njohjen pronarë...”*, me vendimin nr. 1120, datë 29.04.2008, ka vendosur pranimin e saj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 404, datë 22.10.2009. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1302, datë 01.06.2012 ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC-ja).

6. Nga ana tjetër, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit pranë KM-së, pas përfundimit të kontrollit administrativ, ka përgatitur një raport kontrolli, ku rekomandonte që AKKP-ja të rishqyrtonte vendimin nr. 61, datë 29.11.1994 të KKKP-së Vlorë, të vendosej kufizimi i regjistrimit mbi pronën, si dhe gjatë rishikimit të vlerësoheshin provat bashkëngjitur raportit.

7. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, me vendimin nr. 303, datë 06.08.2007, *“Për ushtrimin e së drejtës së iniciativës ndaj vendimeve të dhëna nga ish-KKKP-ja”* ka urdhëruar ushtrimin e së drejtës së iniciativës për kontrollin e ligjshmërisë së dosjeve përkatëse. AKKP-ja, me vendimin nr. 562, datë 24.12.2007 *“Për njohjen e pronësisë, kthimin dhe/ose kompensimin e pronës”*, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit administrativ për shkak të procesit gjyqësor civil që ishte duke u zhvilluar për të njëjtin objekt.

8. Ndërkohë që kishte përfunduar procesi gjyqësor mbi pavërtetësinë e faktit juridik të pronësisë, AKKP-ja, në zbatim të shkresës nr. 556 prot, datë 11.02.2008 të sekretarit të Përgjithshëm të KM-së, me objekt revokimin e vendimit nr. 562, datë 24.12.2007, ka vendosur *“Konstatimin e pavlefshmërisë absolute ndaj vendimit nr. 61/1994; mosnjohjen e së drejtës së pronësisë mbi sipërfaqen 8952 m²...”* me vendimin nr. 193, datë 14.06.2010. Po ashtu, AKKP-ja, me vendimin nr. 215, datë 02.07.2010, ka vendosur: *“T’i njihet pronësia subjektit të shpronësuar Gani Tafili (Hamzai), trashëgimtarëve të tij mbi një pronë truall...dhe t’i kethehet pronësia mbi këtë pronë me sipërfaqe 7852 m²...”*.

9. Kërkuesi i ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore të dyja vendimet e AKKP-së, duke pretenduar se vendimi nr. 193, datë 14.06.2010 i AKKP-së bie ndesh me vendimin nr. 27, datë 27.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesëpadia është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 7035, datë 29.09.2010, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Edhe kërkesëpadia kundër vendimit nr. 215, datë 02.07.2010 të AKKP-së është rrëzuar si e pabazuar në prova dhe në ligj, me vendimin nr. 11198, datë 19.11.2010. Në vitin 2014 kërkuesi është rivendosur në afatin e ankimit kundër vendimit të mësipërm dhe çështja është ende në proces shqyrtimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

II

10. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 30.05.2014, duke pretenduar mosrespektimin nga Gjykata e Lartë të garancive që burojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor. Në mënyrë të përmbledhur në kërkesë parashtrohet si vijon:

10.1 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykatat i kanë mohuar pronësinë mbi pronën pas 15 vjetësh që ajo i ishte njohur e kthyer me vendim të KKKP-së dhe më pas regjistruar në ZRPP Vlorë. Prona objekt gjykimi është poseduar qetësisht mbi 10 vjet, çka do të thotë se trashëgimtarët ligjorë do të ishin bërë pronarë të saj edhe mbi bazën e parashkrimit fitues.

10.2 Është cenuar *e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë*, pasi ndonëse rekursi përmbante shkaqe nga ato që përcakton neni 472 i KPC-së, Kolegji Civil vendosi mospranimin në dhomë këshillimi.

10.2.1 Kolegji Civil nuk ka marrë parasysh pretendimin për mosrespektimin e kërkesës së ligjit *“Për kthimin dhe kompensimin e pronës”*, i ndryshuar, që subjekti që pretendon pronën ka qenë subjekt i shpronësuar dhe, si i tillë, ka të drejtë t’i drejtohet KKKP-së. Ndonëse pala paditëse nuk ka paraqitur prova që të vërtetojnë faktin që ishte subjekt i shpronësuar, Kolegji Civil përsëri nuk e mori parasysh këtë paligjshmëri.

10.2.2 Gjithashtu, Kolegji Civil nuk ka marrë parasysh faktin se pala paditëse ka shmangur rrugën ligjore të kundërshtimit të vendimit të KKKP-së, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Padia me objekt pavërtetësinë e faktit juridik të njohjes së pronësisë së Q.H. për 8952 m², vërtetuar me vendimin nr. 1733, datë 10.10.1993, ishte e pabazuar, pasi si vendim i formës së prerë ai mund të goditej vetëm me kërkesë rishikimi dhe jo përmes ankimit ose rekursit.

10.2.3 Gjykatat në mënyrë të paligjshme kanë cenuar edhe vendimin e KKKP-së, pa pasur padi për anulimin e tij. Vendimi nr. 1120, datë 29.04.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, nga njëra anë pranon pavërtetësinë e pronësisë së Q. H për 8952 m², nga ana tjetër, i njeh G.T. pronësinë mbi 4800 m². Edhe kjo parregullsi e procesit, e parashtruar në rekurs, nuk është marrë parasysh nga Kolegji Civil.

10.2.4 AKKP-ja, me vendimin nr. 193, datë 14.06.2010, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KKKP-së Vlorë dhe mosnjohjen e pronësisë me kufizimet përkatëse. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë, proces i cili aktualisht ndodhet në Gjykatën e Lartë.

10.2.5 Në rekurs është pasqyruar edhe fakti se ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues nuk u është njoftuar palës që nuk ka qenë pjesëmarrëse në seancë, por përsëri Kolegji Civil nuk e ka marrë parasysh këtë pretendim.

10.3 Është cenuar *standardi kushtetues i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi, në kundërshtim me nenin 478 të KPC-së, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk pasqyron kërkesën për administrimin e kërkesave shitesë që kanë rëndësi për çështjen dhe as kërkesën për t'i bashkëngjitur rekursit kopjen e vendimit nr. 2459, datë 22.12.2012. Mungesa e këtyre shkaqeve do të thotë se ato jo vetëm nuk janë marrë parasysh, por as janë arsyetuar në marrjen e vendimit.

11. ***Subjekti i interesuar, Florian Nuri***, ka prapësuar me shkrim si vijon:

11.1 Pretendimi në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të gjësë së gjykuar është i pabazuar, sepse në rastin konkret as është cenuar dhe as është ndryshuar asnjë vendim i formës së prerë. Objekti i padisë, në referim të nenit 391 të KPC-së, ka qenë kundërshtimi i i faktit juridik të vërtetuar me vendim gjyqësor në vitin 1993.

11.2 Po ashtu, i pasaktë është edhe pretendimi se vendimi nr. 1733, datë 13.10.1993 mund të kundërshtohet me kërkesë rishikimi, kjo për faktin se ai vendim është pa palë kundërshtare. Referuar paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 391 të KPC-së, të drejtën e animimit e ka kërkuar e personat fizikë dhe juridikë që janë thirrur të marrin pjesë në proces.

11.3 Edhe pretendimi se subjektet e interesuara duhet të kundërshtonin vendimin e KKKP-së Vlorë në rrugë administrative është i pabazuar, pasi siç rezulton nga aktet e dosjes, paditësit kanë ndërmarrë njëkohësisht si ankimin administrativ ashtu edhe gjyqësor.

11.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për akses në Gjykatën e Lartë, sepse kërkuar ka marrë pjesë si palë ndërgjyqëse në gjashtë procese gjyqësore mbi konfliktin e pronësisë, duke pasur mundësi për të paraqitur çdo provë dhe për të debatuar mbi to.

11.5 Në lidhje me kërkesën për bashkimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, ajo është ekstra ligjore dhe pa bazë konkrete në ligjin procedural civil. Kërkesat janë regjistruar në kohë të ndryshme dhe kanë objekte të ndryshme.

11.6 I pabazuar është edhe pretendimi për ndryshimin e trupit gjykues, sepse kërkuar nuk e ka kundërshtuar këtë fakt.

11.7 Edhe pretendimi për mosrespektimin e standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi Kolegji Civil në dhomë këshillimi ka marrë në shqyrtim të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs dhe ka vlerësuar se nuk përfshihen në rastet e nenit 472 të KPC-së.

12. ***Subjekti i interesuar, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë***, nuk ka depozituar prapësime, por në mënyrë të përmblendhur ka parashtruar të dhënat që rezultojnë në lidhje me pasurinë objekt gjykimi, si dhe ka vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit në bazë të të cilit është kryer regjistrimi i pasurisë.

III

A. Në lidhje me formimin e trupit gjykues

13. Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të çështjes, gjyqtarët Fatos Lulo dhe Besnik Imeraj kanë paraqitur kërkesë me shkrim, përmes së cilës, në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kanë kërkuar dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, me argumentin se ata kanë marrë pjesë në gjykimin e së njëjtës çështje në Gjykatën e Lartë. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e ka vlerësuar si të bazuar kërkesën dhe ka vendosur pranimin e saj në përputhje me nenin 36, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për këto arsye çështja është gjykuar nga një trupë e përbërë nga shtatë gjyqtarë.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

14. Kërkuesi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk janë respektuar garancitë që burojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke cenuar për rrjedhojë parimin e sigurisë juridike, të drejtën e aksesit dhe standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

15. Gjykata, pasi mori në shqyrtim këto pretendime të kërkuesit, gjatë votimit në lidhje me to nuk arriti shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj për asnjërën prej tyre¹. Në kushtet kur asnjë përfundim i çështjes nuk u votua nga shumica e kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit organik, arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuesit duhet të refuzohet. Megjithatë, ajo rithekson se në referim të përcaktimeve të nenit 74, refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesi ta riparaqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g”, dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari

¹ Votuan për pranimin gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj e Fatmir Hoxha. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Vladimir Kristo, Sokol Berberi e Gani Dizdari.